



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 342 / Prot.

Tiranë, më 05 /05/2015

VENDIM  
“Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 30 , datë 05/05/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

**V Ë R E N:**

Ankuesi/Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 342 Prot., datë 20.04.2015, ndaj Shoqërisë “Sigal Uniqa Group Austria”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit”. Ankuesi/ Z. në cilësinë e kërkuarit ka kërkuar me anë të shkresave Nr. 110 Prot., datë 07.07.2014, Nr. 162 Prot., datë 26.11.2014, Nr. 169 Prot., datë 12.12.2014, Nr.206 Prot., datë 24.03.2015, me objekt “Kërkesë për informacion” të informohet për shumën e dëmshpërblimit të dëmit të shkaktuar në një aksident automobilistik me datë 27.02.2012 si pasojë e të cilit është dëmtuar Z.

Komisioneri, në përputhje me pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, paraprakisht ka verifikuar ekstraktin e Shoqërisë “Sigal Uniqa Group Austria” për të përcaktuar nëse Shoqëria “Sigal Uniqa Group Austria” bën pjesë në përcaktimet e nenit 2 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, rrjedhojë e të cilës është zbatimi ose jo i kërkesave të këtij ligji. Nga ky verifikim rezultoi se Shoqëria “Sigal Uniqa Group Austria” nuk është autoritet publik sipas përkufizimit të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

**PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

**V E N D O S A:**

1. Rrëzimin e ankesës nr. 342 Prot., datë 20.04.2015 të Z. , ndaj Shoqërisë “Sigal Uniqa Group Austria”.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 05.05.2015.

